



---

# ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

---

*Dokument i shkurtër për politikë publike, nëntor 2017*

*Autor: d-r Goran Kovačev*

*Projekti financohet nga Bashkimi Evropian*

*Ky publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit European.  
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Instituti  
për Demokraci Societas Civilis dhe Qendra për analiza  
ekonomike dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet  
e Bashkimit European*

ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT  
TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351:657.47(497.7)(047.31)

KOVAÇEV, Goran

Analizë e shpenzimeve të procesit të ndikesës së rregullativës : dokument i shkurtër për politikë publike, nëntor 1027 / autor Goran Kovaçev. - Shkup : Qendra për analiza ekonomike - CEA, 2017. - 31 стр. : табели ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 30-31

ISBN 978-608-4731-41-2

а) Јавна политика - Регулатива - Анализа на трошоци - Македонија - Истражувања

COBISS.MK-ID 105484298



# ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

---

*Dokument i shkurtër për politikë publike, nëntor 1027*

*Autor: d-r Goran Kovaçev*

## HYRJE

Vlerësimi i ndikesës së rregullativës (VNRR) paraqet “metodë për analizë të politikave publike, i cili është dedikuar që t’ju ndihmojë krijuesve të politikave në dizajnin, zbatimin dhe monitorimin e përmirësimit të sistemeve rregullatore, duke siguruar metodologji për vlerësim të pasojave të mundshme nga rregullativa e propozuar dhe pasoja reale nga ajo aktuale”.<sup>1</sup>

Që nga fillimi i aplikimit të sak (në vitin 1974 në SHBA) përfundimisht me vitin 2014, 34 nga 35 vende anëtare të Organizatës për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (OECD) e shfrytëzojnë VNRR si metodë mbi të cilën mbështet vendimmarrja gjatë krijimit të politikave dhe të rregullativës.<sup>2</sup>

- 
1. Colin H. Kirkpatrick and David Parker -Regulatory Impact Assessment: Towards Better Regulation? CRC Series on Competition, Regulation and Development, Cheltenham, Edward Elgar Publishing (2008),p. 1
  2. Види: Figure 4.3.Trend in RIA adoption across OECDcountries, достапно на: [http://www.keepeek.com/Digital-Asset-Management/occd/governance/occd-regulatory-policy-outlook-2015/trend-in-ria-adoption-across-occd-countries\\_9789264238770-graph39-en#.WNJfYfkrKUK](http://www.keepeek.com/Digital-Asset-Management/occd/governance/occd-regulatory-policy-outlook-2015/trend-in-ria-adoption-across-occd-countries_9789264238770-graph39-en#.WNJfYfkrKUK). Qasur më datën 30.10.2017.

Fillimet e VNRR në Maqedoni datojnë nga viti 2008, në fillim si pilot-projekt, që nga viti 2009 të bëhet e obligueshme për të gjitha propozimet ligjore si pjesë e reformave rregulatore me qëllim deklarativ – përmirësim i ambientit sipërmarrës. Në vitin 2011, Ministria e shoqërisë informatike dhe i administratës (MSHIA) u bë institucioni kryesor që është përgjegjës për zbatim, koordinim dhe mbikëqyrje të VNRR, ndërsa në vitin 2013 u aplikua Metodologjia e re për VNRR. Karakteristikë kryesore e Metodologjisë është niveli më i madh i decentralizimit dhe thjeshtësimi dhe ajo është tërësisht e harmonizuar me sistemin ekzistues për planifikim strategjik në ministritë dhe procedurat për koordinim të politikave dhe miratim të vendimeve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Metodologjia paraqet përsosje të praktikave ekzistuese të aplikuara në vitin 2009, të cilat në të njëjtën kohë janë të përsosura sipas përvojave pozitive në Unionin Evropian (UE) dhe vendet – anëtare të tij, si dhe vendet-anëtare të OECD.<sup>1</sup>

Akte të cilat e rregullojnë materien për VNRR janë: Metodologjia për vlerësim të ndikesës së rregullativës (Gaz. Zyrtare e RM nr. 107/13), Udhëzim për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikesës së rregullativës (Gaz. Zyrtare e RM nr. 106/13), Vendim për formën dhe përmbajtjen e raportit për vlerësim të ndikesës së rregullativës (Gaz. Zyrtare e RM nr. 106/13) dhe Doracak për vlerësimin e ndikesës së rregullativës.

## PROCESI I VLERËSIMIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

---

Procesi i VNRR paraqet një varg i aktiviteteve në të cilat realizohen analiza dhe grumbullohen të dhëna relevante, në bazë të të cilave

---

3. Metodologjia për vlerësim të ndikesës së rregullativës, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 107 e datës 30.7.2013.

përzgjidhet zgjidhja më e mirë e problemit gjatë rregullimit të fushave të caktuara për arritje të qëllimeve të propozim ligjit në konsultim me palët e prekura (subjektet afariste, odat ekonomike, shoqatat dhe fondacionet si dhe të gjitha personat e tjera fizike dhe juridike).<sup>4</sup> Procesi i VNRR kontribuon për **përmirësim të efikasitetit ekonomik** përmes analizës për përcaktim të atyre aspekteve të rregullativës të cilat mund ta kufizojnë zgjedhjen e konsumatorëve ose ta zvogëlojnë shkallën e konkurrencës në ekonominë. Gjithashtu, ky proces mundëson që të përcaktohen dhe të sillen në minimum ngarkesat e mundshme për subjektet afariste, posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe për qytetarët. Me që procesi parashikon konsultime me palët e prekura, VNRR mundëson **të përcaktohen efektet e pa parashikueshme dhe të padëshirueshme** të cilat paraprakisht nuk kanë mund të perceptohen. Në të njëjtën kohë, VNRR kontribuon **ndaj respektimit të parimeve të qeverisjes së mirë** sepse e rrit transparencën dhe legjitimitetin e procesit rregullator. Me pjesëmarrjen e palëve të prekura në procesin sigurohet mbrojtje e interesave të tyre dhe të mundësisë për modelim të politikave sipas nevojave të palëve të prekura besueshmëria për respektim dhe arritje të qëllimeve të rregullativës. Më në fund, ky proces kontribuon edhe për rritje të efikasitetit dhe efektivitetit në sektorin publik përmes avancimit të përgatitjes së rregullativës dhe të analizës së ndikesave, shpenzimeve dhe përfitimeve të mundshme nga zgjidhjet e propozuara, me çka përcaktohen zgjidhje optimale për arritje të qëllimeve. Faktikisht, VNRR ka rol të dyfishtë:

- Paraqet proces të vazhdueshëm i cili mundëson që të analizohen shkaqet për aplikim të masave konkrete, për tu përcaktuar zgjidhjet e mundshme përkatësisht opsionet për arritje të qëllimit, të hulumtohen dhe të kuptohen pasojat nga masat e propozuara dhe të kyçen palët e prekura në të gjitha fazat e procesit;

4. Udhëzim për mënyrën e veprimit në punën e ministrive në procesin e zbatimit të vlerësimit të ndikesës së rregullativës, Gazeta Zyrtare e RM nr. 106 e datës 29.7.2013

- Paraqet edhe mjet e cila ndihmon gjatë përgatitjes së propozim rregullativës përmes analizimit të shpenzimeve dhe përfitimeve të mundshme, si dhe rreziqet të cilat të mund të kenë ndikese mbi qytetarët, ekonominë, subjektet afariste, shoqërinë dhe ambientin jetësor në afat më të gjatë.<sup>5</sup>

Në pajtim me Metodologjinë, procesi për VNRR zbatohet përmes hapave vijuese:

- planifikim strategjik i procesit të zbatimit – në të cilin përcaktohet shkalla e ndikesave të mundshme nga propozim ligji, palët e prekura, të dhënat e nevojshme për të bërë analiza përkatëse dhe resurset e nevojshme për zbatimin e procesit të VNRR;
- zbatimi i procesit të VNRR;
- përgatitje e Raportit dhe marrje e mendimit nga MSHIA dhe
- konsultim me palët e prekura.

Në praktikë, dizajni i procesit të zbatimit të VNRR në Maqedoni është i ngjashëm si edhe në vendet e tjera, me specifika karakteristike për rregullativën e ndryshme për rregullativën e ndryshme nacionale, vendosjen institucionale dhe dallimet shoqëroro-kulturore. (diagrami 1). Në diagramin, drejtkëndëshit me ngjyrë të portokalltë e shënojnë zgjedhjen e opsionit “mos bëj asgjë”, ndërsa ato me të kaltër do të thonë respektim i afateve të dhëna në mënyrë të saktë dhe prerë të cilat janë të theksuara në kllapat.


---

5. Doracak për vlerësimin e ndikesës së rregullativës – Ministria e shoqërisë informatike dhe administratës (2013), fq. 6-7



# ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

**Diagram 1:** Hapa të procesit të VNRR



# NEVOJË PËR ANALIZË TË SHPENZIMEVE TË PROCESIT TË VLERËSIMIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

---

Nevoja për analizë të shpenzimeve në procesin e VNRR buron nga një nga parimet themelore të qeverisjes së mirë, e ai është **efektiviteti dhe efikasiteti**, përkatësisht arritje e qëllimeve të dëshiruara përmes analizës së plotë dhe vlerësim të ndikesave nga mënyrat e mundshme për zgjidhje të problemeve (çështjeve) dhe gjetje të zgjidhjes e cila do t'i arrijë qëllimet me shpenzime më të vogla për buxhetin, subjektet afariste dhe qytetarët.

Metodologjia për VNRR përshkruan analizë të shpenzimeve, ndikesave dhe përfitimeve nga zgjidhjet e përcaktuara të mundshme gjatë propozimit të rregullativës së caktuar, si edhe përgatitje të Raportit për VNRR. Ajo parashikon se gjatë analizimit të zgjidhjeve (opsioneve) të mundshme, përdoren metoda dhe mjete të ndryshme analitike. Një pjesë e tyre janë këto që vijojnë:

a) *Analiza e shpenzimeve dhe përfitimeve* – metodë e cila përdoret për përcaktimin e vlerës monetare (në denarë) për përfitimet dhe shpenzimet dhe krahasim se si ato vlera do të lëvizin në periudhën paraprakisht të përcaktuar kohor.

b) *Analizë e efikasitetit të shpenzimeve* – nënkupton realizim të raportit më të mirë midis mjeteve të shpenzuara dhe rezultateve të arritura.

v) *Analizë në sajë të më shumë kritereve* – në raste kur përfitimet nuk mund të shprehen në formë monetare (në denarë) mundësohet që analiza të bëhet sipas disa kritereve të ndryshme.

g) *Analizë e ndjeshmërisë* - përdoret për të hulumtuar se në çfarë mënyrë opsionet që analizohen do të ishin ndryshuar si rezultat të variacioneve në parametrat kyç dhe çfarë është ndikesa e tyre e ndërsjellë.

d) *Analizë e rreziqeve* – bëhet për shkak të përcaktimit të mënyrës më të mirë për ballafaqim me rreziqet edhe atë në raste kur problemi që analizohet është i ndërlikuar me rrezik, përkatësisht kur ekziston besueshmëri që problemi të zhvillohet në më shumë mënyra të mundshme.

gj) *Model i shpenzimeve standarde* – analizohen shpenzimet administrative të cilat u janë imponuar subjekteve afariste dhe qytetarëve si rezultat i respektimit të obligimit ligjor.

Zgjidhjet e përcaktuara të mundshme nga të gjitha analizat duhet të analizohen me përdorim të të njëjtave metoda dhe mjete analitike që pastaj të mund të krahasohen. Qëllimi i analizës është që të përfitohet një pasqyrë e qartë për shpenzimet, ndikimet pozitive dhe negative dhe përfitimet që do të dilnin nga çdo njëra nga zgjidhjet e mundshme për të mund të përcaktohet cili nga opsionet do të sjellë në qëllimet e planifikuara, me kosto më të ulëta dhe me më pak efekte të padëshiruara. Secila nga zgjidhjet e përcaktuara të mundshme të mund të shkaktojnë lloj dhe shkallë të ndryshme të shpenzimeve dhe ndikimeve të cilat konstatohen në mënyrë sa më saktë të mundur. Gjatë analizës duhet të përcaktohen:

- shpenzimet/përfitimi për buxhetin;
- shpenzimet/përfitimi për subjektet afariste, posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, grupe të tjera dhe qytetarët (në varësi nga ajo se me cilin ka të bëjë propozimi i ligjit);
- ndikesat mbi ekonominë, ambientin jetësor dhe shëndetin e njerëzve si dhe lloje të tjera të ndikesave varësisht nga fusha;
- shpenzimet dhe resurset për zbatim, përcjellje dhe kontroll, si dhe evaluimi i çdo njëres nga zgjidhjet e mundshme;
- pranimi/rezistenca e cila mund të paraqitet gjatë zbatimit dhe
- efektet dhe ndikesat negative ose të padëshiruara.

Në sajë të krahasimit midis zgjidhjeve (opsioneve) të përcaktuara të mundshme, nga ministria propozohet zgjidhja e cila në mënyrë

më efektive do të kontribuojë drejt arritjes së qëllimeve të përcaktuara të propozim-ligjit dhe përfitimet do të arrihen me më pak shpenzime dhe efekte të padëshiruara. Në bazë të zgjidhjes së propozuar përgatitet teksti i propozimit të ligjit. Praktikisht VNRR, para së gjithash, është mjet për analizë mikroekonomike, mjet që kërkon shumë ushtrime dhe resurse.<sup>6</sup>

Për fat të keq, në Vendimin për formën dhe përmbajtjen e Raportit për vlerësim të VNRR nuk është parashikuar analizë e shpenzimeve të vetë procesit të VNRR. Ngjashëm me atë, ky dokument i shkurtër i politikës publike e thekson nevojën për hartimin e një analizë të shpenzimeve të procesit të VNRR, për arsye të thjeshtë se është e nevojshme të shihet se sa e kushton shtetin (me atë edhe subjektet afariste edhe qytetarët) hartimin e VNRR për një propozim-ligji dhe nëse këto shpenzime janë të arsyeshme në krahasim me efektet që do t'i shkaktojë ndryshimi i rregullativës që është lëndë e vlerësimit.

Për tu kryer një analizë e këtillë është e nevojshme që të zhvillohet një matricë e gjerë e treguesve që do të paraqet bazë për vlerësim. Zgjedhja e treguesve duhet ta marrë parasysh qëllimin e rregullativës për ndikimin e të cilës bëhet vlerësim i qasshmërisë në dhëna cilësore.

Duke i marrë parasysh përvojat botërore, është e nevojshme që modeli për vlerësimin e efektivitetit të VNRR në Maqedoni të ndërtohet në sajë të treguesve me shumë nivele, të bazuara mbi parime dhe të zhvilluara në varësi nga prioritetet shoqërore. Shembull për atë lloj të prioriteteve gjejmë në raportin e OECD në lidhje me treguesit për menaxhim me sistemin rregullativ, tregues që ju referohen karakteristikave kryesore të procesit përmes të cilit është krijuar, miratuar dhe zbatuar rregullativa,

---

6. Rex Deighton-Smith, Angelo Erbacci and Celine Kauffmann - Promoting inclusive growth through better regulation: The role of regulatory impact assessment, OECD Regulatory Policy Working Papers, No. 3, OECD Publishing, Paris. (2016), <http://dx.doi.org/10.1787/5jm3tqwqp1vj-en>, Qasur me datën 2.11.2017.

duke e marrë parasysh planifikimin, konsultimet për VNRR, zvogëlimin e obligimeve administrative dhe dimensionet dhe mjetet e tjera.<sup>7</sup>

Sipas këtij raporti, çdo vend në raport me VNRR mund të parashtrijë katër prioritete: administrative, ekonomike, demokratike dhe procedurale. Për nevojat e këtij dokumenti, përkatësisht për nevojat e analizës financiare të VNRR, jahstëzakonisht janë të rëndësishme prioritetet administrative dhe ekonomike në bazë të të cilave mund të vendosen treguesit për vlerësim. Ato tregues janë të paraqitur në tabelën më poshtë.

Prioritete në bazë të të cilave mund të vendosen tregues për analizë financiare të procesit të VNRR

ADMINISTRATIVE	EKONOMIKE
Sa kohë është e nevojshme të zbatohet politika rregulatore (PRR) duke llogaritur në mënyrë kronologjike nga fillimi deri në fund?	Çfarë është midis shpenzimeve dhe përfitimeve nga PRR?
Sa shpenzon Qeveria për zbatimin e PRR në raport me resurset njerëzore, përkatësisht numrit të personave, proporcionalitetit në raport me të punësuarit e kështu me radhë?	Sa PRR janë efikase, përkatësisht sa janë përfitimet në para?
Sa shpenzon Qeveria për zbatimin e PRR në raport me resurset financiare, përkatësisht shpenzimeve monetare, proporcionalitetin në raport me buxhetin e kështu me radhë?	Çfarë janë ndikesat e PRR mbi ekonominë e gjithmbarshme, përkatësisht mbi punësimet, shkallës së konkurrencës, inovacioneve dhe ngjashëm?


Në mënyrë shtesë, siç është prezantuar në dijagramin 2, treguesit mund të përcaktohen si:

- tregues hyrës (të ndërlidhur me aspekte të resurseve të nevojshme për aplikimin dhe zbatimin e VNRR);
- tregues dalës, përkatësisht për rezultatin dalës (të ndërlidhur me atë që fitohet nga zbatimi i VNRR);

7. Повеќе kaj: Claudio Radaelli and Oliver Fritsch - Measuring Regulatory Performance, Evaluating regulatory management tools and programmes, OECD, (2012) pp 38-63

- tregues afatmesëm (midis fazave), të bazuar mbi perceptcionet për suksesin e procesit dhe
- tregues të ndërlidhur me rezultatin përfundimtar – sa me të vërtetë procesi i gjithmbarshëm i VNRR kontribuon në realizimin e prioriteteve për të cilat është krijuar?

**Diagram 2:** Kategori në bazë të të cilave mund të nxirren treguesit



## MODEL I ANALIZËS SË SHPENZIMEVE TË PROCESIT PËR VLERËSIM TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

---

Duhet të pranohet se për shkak të kompleksitetit të procesit të VNRR, praktikisht është e pamundur të analizohen në mënyrë metodologjike dhe financiarisht saktë të përpilohet analizë e shpenzimeve të tij. Në sajë të asaj që është thënë paraprakisht, ky dokument për politikë publike do të bëjë përpjekje që të përpunojë metodologji për analizë financiare të procesit të VNRR, duke i marrë parasysh hapat e prezantuara në diagramin. Qëllimi është që përafërsisht të përcaktohet se sa do ta kushtojë shtetin vetë procesi i VNRR për një propozim-ligj, e jo sa do ta kushtojë shtetin ose faktorët në tërësi zbatimi i atij ligji të ri të hartuar sipas VNRR. Kostoja që do të rezultonte nga kjo përllogaritje do të kishte qenë vetëm një komponent hyrës në përllogaritjen e kostos së rregullores mbi subjektet afariste dhe qytetarët. Çmimi i përgjithshëm nga puna, siç tanimë është prezantuar më lartë, përllogaritet në mënyrë shumë më komplekse.

Metodologjia për analizë financiare të VNRR përbëhet nga përllogaritja e shpenzimeve të:

- punës së investuar në procesin e VNRR;
- kohëzgjatja e procesit të VNRR;
- trajnimet e nevojshme për hartimin e VNRR;
- shërbimet konsulente dhe
- shpenzime të tjera operative.

# PËRLLOGARITJE E SHPENZIMEVE TË PUNËS NË PROCESIN E VLERËSIMIKT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

Baza fillestare e metodologjisë për analizë financiare të VNRR është përlllogaritja e shpenzimeve të punës. Kostoja e punës është njëra nga kategoritë më komplekse të përlllogaritjes për shkak të faktit se është jashtëzakonisht vështirë të përcaktohet saktësisht se sa njerëz kanë punuar në procesin e VNRR, sa kohë kanë shpenzuar, përkatësisht në çfarë vëllimi të ditës së punës i janë përkushtuar kësaj problematike, ku dhe kur janë mbivendosur detyrimet me kolegët e tjerë dhe ngjashëm Për më tej, vështirë është të përcaktohet se sa niveli i arsimit dhe i vendit të punës ndikojnë në cilësinë e kontributit individual në procesin e VNRR.

Në tabelën 1 është prezantuar përlllogaritja e kostos së punës në procesin e VNRR.

**Tabela 1:** Përlllogaritje e kostos së punës në procesin e VNRR

1	2	3	4	5	6	7	8
Numri radhor	Persona të angazhuar	Institucion	Kategori e vendit të punës	Shkallë e arsimit	Koeficient i kategorisë së vendit të punës	Koef. I shkallës së arsimit	Fazë
1							
2							
3							
<b>Gjithsej</b>	<b>a</b>	<b>b</b>					

9	10	11	12	13=11*12	14	15=6*7*13*14
Aktivitet	Datë e angazhimit	Gjithsej ditë kalendarike	Përqindje nga angazhimi ditor	Gjithsej angazhim	Lartësi e mëditjes (MKD)	Kosto për punën (MKD)
				<b>v</b>		<b>g</b>



ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT  
TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

Në vazhdim vijon udhëzimi i shkurtër për plotësim të tabelës.

- *kolona 1* – shënohet numri radhor i personit të angazhuar;
- *kolona 2* – theksohet emri dhe mbiemri i personit të angazhuar;
- *kolona 3* – theksohet institucioni prej ku vjen personi i angazhuar;
- *kolona 4* – theksohet kategoria e vendit të punës së nëpunësve administrativ: A (sekretarë), B (nëpunës udhëheqës administrativ), V (nëpunës profesional administrativ) ose G (nëpunës ndihmës-profesionist administrativ), në përputhje me nenin 22 të Ligjit për nëpunës administrativ (Gaz. Zyrtare e RM 27/2014);
- *kolona 5* – shënohet shkalla e arsimit (Klasifikimi Ndërkombëtar Standard i Klasifikimit të Arsimit - MNSKA 0-8) sipas Klasifikimit standard ndërkombëtar të arsimit. Zakonisht bëhet fjalë për MNSKA 6 (arsim i lartë), MNSKA 7 (arsim i magjistraturës) dhe MNSKA 8 (arsim i doktoranturës);
- *kolonat 6 dhe 7* – plotësohen në pajtim me matricën e prezantuar më poshtë;

Matricë e koeficienteve

- *kolona 8* – theksohet se në cilën nga dy fazat (planifikimi strategjik ose zbatimi i VNRR) graviton aktiviteti konkret;

Kategoria e vendit të punës	Koeficient i kategorisë së vendit të punës	Shkalla e arsimit	Koef. i shkalës së arsimit
A	2,0	MCKOB 8	1,5
B	1,5	MCKOB 7	1,2
B	1,2	MCKOB 6	1,0
Г	1,0	MCKOB 0-5	1,0

- *kolona 9* – theksohet një nga dhjetë aktivitetet konkrete të cilën e realizon personi (analizë e situatës, definimi i problemeve, analizë e ndikesave, definimi i qëllimeve, përcaktimi i zgjidhjeve-opsioneve të mundshme, analizë e kostove dhe definimi i zgjidhjes optimale, përgatitje e projekt-ligjit, përgatitje e projekt-raportit për VNRR, hartimi i mendimit nga MSHIA, përgatitja e projekt-raportit për VNRR);
- *kolona 10* – shënohet data fillestare kur personi është angazhuar në procesin e VNRR;
- *kolona 11* – shënohet numri i përgjithshëm i ditëve kalendarike në të cilat personi i angazhuar ka punuar në VNRR për ligjin përkatës;
- *kolona 12* – shënohet përqindja e përafërt nga dita (pjesa nga angazhimi ditor) në të cilin personi i angazhuar i është kushtuar VNRR;
- *kolona 13* – paraqet prodhim nga kolonat 11 dhe 12, përkatësisht e paraqet numrin real të ditëve të punës të cilat personi i angazhuar ja ka kushtuar VNRR;
- *kolona 14* – shënohet shuma e mëditjes sipas të dhënave për bruto-pagën mesatare të publikuara në Entin shtetëror për statistikë të Republikës së Maqedonisë;
- *kolona 15* – përllogaritet kostoja e punës si prodhim nga kolonat 6, 7, 13 dhe 14.

## PËRLLOGARITJE E SHPENZIMEVE TË TJERA NË PROCESIN E NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

Përllogaritja e shpenzimeve të tjera në procesin e VNRR do të duhej të jetë më e thjeshtë, duke pasur parasysh se ato janë më lehtë të matshme dhe mund shprehen në vlerë monetare.

Nëse është e nevojshme që ndonjë nga personat e angazhuar në procesin e VNRR nga administrata publike të vijojë trajnimin në drejtim të avancimit të ekspertizës për VNRR, shpenzimet për atë trajnim do të ishin paraqitur në mënyrën si në tabelën 2.

Me parimin e njëjtë përllogariten edhe shpenzimet për shërbime eventuale konsultimi (tabela 3).

Shpenzimet e angazhimit të institucioneve që ndërlidhen me konsultimet e palëve të prekura janë paraqitur në tabelën 4.

Tabela 5 i paraqet shpenzimet e bëra nga palët e interesuara për analizë të gjendjeve dhe pjesëmarrje në procesin e konsultimit. Plotësohet përmes anketës të palëve të prekura

Në fund, bëhet përllogaritje e shpenzimeve të tjera operative në të cilat hyjnë: furnizimet për zyrë, komunalet, energenset, pajisja eventuale që është furnizuar për nevojat e procesit të VNRR dhe ngjashëm (tabela 6).

Pas përllogaritjes së të gjitha shpenzimeve individuale të procesit të VNRR, bëhet një tabelë përmbledhëse e sistemuar e cila si rezultat përfundimtar e jep shpenzimin e tërësishëm të procesit të VNRR për një propozim-ligj të caktuar (tabela 7). Nëse personat ose institucionet përsëriten në fazat e ndryshme të përllogaritjes, numri i tyre në tabelën përmbledhëse nuk kumulohen por shënohet numri real i personave ose institucioneve të angazhuara.

**Tabela 2: Shpenzime për trajnim**

n.r.	Titull i trajnimit	Pjesëmarrës i trajnimit	Institucion	Periudhë e trajnimit	Ditë	Shpenzime për trajnim (MKD)
<b>gjithsej</b>		<b>d</b>	<b>gj</b>		<b>e</b>	<b>zh</b>

**Tabela 3: Shpenzime për shërbime konsulente**

n.r.	Titull i shërbimit konsulent	Konsulent/ekspert	Institucion	Periudhë e shfrytëzimit të shërbimit	Ditë	Shpenzime për shërbimin (MKD)
<b>gjithsej</b>		<b>z</b>	<b>x</b>		<b>i</b>	<b>j</b>

**Tabela 4: Shpenzime të institucioneve për konsultime me palët e interesuara**

n.r.	Titull/emër i palës së interesuar	Periudhë e konsultimit	Ditë	Shpenzime për konsultime me palët e interesuara (MKD)
<b>gjithsej</b>	<b>κ</b>		<b>ll</b>	<b>lj</b>

**Tabela 5: Shpenzime të palëve të interesuara për analizë të gjendjeve dhe pjesëmarrje në konsultimet**

<b>Emër/titulli i palës së interesuar:</b>			
	Numri i palëve të përfshira	Ditë	Shuma e shpenzimeve (MKD)
Analiza të gjendjeve			
Pjesëmarrje në konsultimet			
<b>gjithsej</b>	<b>m</b>	<b>n</b>	<b>nj</b>

**Tabela 6: Shpenzime operative**

n.r.	Lloji i shpenzimit operativ	Shumë (MKD)
1	Furnizime zyre	
2	komunale	
3	Benzinë dhe energjense të tjera	
4	pajisje	
5	Shpenzime të tjera operative	
<b>gjithsej</b>		<b>o</b>

ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT  
TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS

**Tabela 7:** Shpenzim për procesin e VNRR

n.r.	Lloji i shpenzimit	Numri i personave	Numri i institucioneve	Ditë	Shumë (MKD)
1	punë	a	b	v	g
2	trajnim	d	gj	e	zh
3	shërbime konsulente	y	x	i	j
4	konsultime me palët e interesuara		k	l	lj
5	shpenzime të palëve të interesuara	m		n	nj
6	shpenzime të tjera operative				o
	<b>gjithsej</b>			<b>v+...+n</b>	<b>g+...+o</b>

**Vërejtje:** Si shtojcë e këtij dokumenti është punuar Mjet i platformës Microsoft Excel në të cilën është prezantuar simulim i Metodologjisë përmes një shembulli hipotetik për ndryshim të ligjit nga fusha e tatimeve. Kjo përbëhet nga pesë fletë duke e përcjellë klasifikimin e prezantimit të shpenzimeve. E fundit prej tyre është shuma kontabiliste i zërave paraprake ekonomike për nevojës e mjetit.

## KONKLUZA DHE REKOMANDIME

---

Qëllimi kryesor i këtij dokumenti për politikë është përcaktimi i kostos për shtetin gjatë vetë procesit të VNRR për një propozim-ligj.

Ky dokument nuk ka për qëllim të përcaktojë se sa zbatimi i atij ligji të ri të hartuar sipas VNRR do ta kishte kushtuar shtetin ose faktorët në tërësi. Kjo tanimë është bërë me Metodologjinë për VNRR e cila përshkruan analizë të shpenzimeve të shpenzimeve, ndikesave dhe përfitimeve nga zgjidhjet e përcaktuara të mundshme gjatë propozimit të rregullativës së caktuar dhe përgatitjes së Raportit për VNRR.

Mirëpo, në Vendimin për formën dhe përmbajtjen e Raportit për vlerësim të VNRR nuk është paraparë analizë e shpenzimeve të vetë procesit të VNRR.

Rekomandim i këtij dokumenti është: Qeveria e Republikës së Maqedonisë të miratojë “Ndryshim dhe plotësim të formës dhe të përmbajtjes së Raportit për vlerësim të ndikesës së rregullativës” dhe kjo në mënyrën vijuese:

- Në Shtojcën “Raport për vlerësimin e ndikesës së rregullativës”, pika 4.5 të plotësohet me aline v) shpenzime për procesin e VNRR.
- Në “Udhëzimin për plotësim të Raportit për vlerësim të ndikesës së rregullativës”, pika 4.5 të plotësohet me aline v) shpenzime për procesin e VNRR (theksohen shpenzime për punën e punëtorëve administrativ të përfshirë në procesin e VNRR, shpenzimet për trajnime, shpenzimet për shërbime konsulente, shpenzimet e bëra për konsultim me palët e interesuara dhe shpenzimet operative të bëra në procesin e VNRR).
- Të miratojë “Udhëzim për përlogaritje të shpenzimeve të procesit të vlerësimit të ndikesës së rregullativës”, në pajtim me metodologjinë e përshkruar në këtë dokument.

Në atë mënyrë, Raporti do ti tregojë shpenzimet e bëra për vetë procesin e VNRR të cilat do të jenë një komponentë hyrëse gjatë vlerësimit të ndikesës mbi shtetin dhe faktorët.

Parakusht kryesor për analizë cilësore të shpenzimeve të procesit të VNRR është qasshmëria dhe sa janë të azhurnuara të dhënat financiare. Mos-konsekuenca ndaj këtij parakushti ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në shprehjen e drejtë të shpenzimeve, në pajtim me praktikat e mira të punës kontabiliste-financiare.

Pikërisht për këtë, ky dokument rekomandon përfshirje strategjike të Entit shtetëror për revizion (ESHR) si korrektues i analizës së shpenzimeve në procesin e VNRR dhe shfaqjen e tyre të drejtë.

Nëse në një ardhmëri të afërt aplikohet mjeti “Kalkulator i rregullativës”,<sup>8</sup> rekomandim i këtij punimi është që bashkë me të, midis të tjerave, të përfshihet edhe përlllogaritja e shpenzimeve të procesit të VNRR.

---

8. Në pajtim me rekomandimet e: Jovan Bliznakovski – Praktika të mira komparative të aplikimit të VPN edhe mundësi për implementimin e tyre në Maqedoni (dokument për politikë publike), Institut për demokraci “Societas civilis” dhe “Qendra për analiza ekonomike” (2017), fq. 26

## BIBLIOGRAFIA

---

- Bliznakovski, J. – *Praktika të mira komparative të aplikimit të VPN edhe mundësi për implementimin e tyre në Maqedoni (dokument për politikë publike)*, Institut për demokraci “Societas civilis” dhe “Qendra për analiza ekonomike” (2017)
- Deighton-Smith R., Erbacci A. & Kauffmann C. - *Promoting inclusive growth through better regulation: The role of regulatory impact assessment*, OECD Regulatory Policy Working Papers, No. 3, OECD Publishing, Paris (2016)
- Kirkpatrick H. C. & Parker D. - *Regulatory Impact Assessment: Towards Better Regulation* CRC Series on Competition, Regulation and Development, Cheltenham, Edward Elgar Publishing (2008)
- Ministria e shoqërisë informatike dhe e administratës – Doracak për vlerësimin e ndikesës së rregullativës (2013)
- Radaelli C. & Fritsch O. - *Measuring Regulatory Performance, Evaluating regulatory management tools and programmes*, OECD (2012)
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 106/13, 107/13 dhe 27/2014
- <http://www.keepeek.com>



---

# **ANALIZË E SHPENZIMEVE TË PROCESIT TË NDIKESËS SË RREGULLATIVËS**

---

*Dokument i shkurtër për politikë publike, nëntor 2017*

*Autor: d-r Goran Kovaçev*

*Projekti financohet nga Bashkimi Evropian*